

# RAPORTI VJETOR I PROGRAMIT 2010-11



Program finansiari EU



Schweizerische Eidgenossenschaft  
Confédération suisse  
Confederazione Svizzera  
Confederaziun svizra

Swiss Agency for Development  
and Cooperation SDC



Sprovodi program



Partneriteti Evropian me Komunitat

## Përmbledhje ekzekutive

Partneriteti Evropian me Komunitet- PROGRES, Program i përbashkët për zhvillim i Bashkimit Evropian, Qeverisë së Zvicrës dhe Qeverisë së Serbisë, ka arritur rezultate të shkëlqyeshme gjatë vitit të parë në Serbinë jugore dhe jugperëndimore: janë kontraktuar 40 projekte të Pjesëmarrjes Qytetare, 21 projekte të infrastrukturës lokale, 12 plane urbanistike, 3 qendra të reciklimit dhe 3 qendra të asistencës, përdorura janë themeluar gjashtë Këshille për barazi gjinore, si rezultat i përkrahjes së PROGRES-it. Pesë vizita ambasadoriale i dhanë një përkrahje të veçantë Programit dhe kontribuan në vizibilitetin e shkëlqyeshëm të PROGRES-it: mbi 500 raporte në media dhe mbi 10,670 vizita të website-it.

Përkundër vonesave të vogla në implementim, aktivitetet dhe avancimet rreth arritjes së qëllimeve të Programit janë në rrugë të mirë: më shumë se 5.5 milion EUR nga 14.9 mil EUR të kontraktuara deri më sot, janë implementuar. Kjo nuk mund të thuhet për normën e disbursimit që ka qenë në nivel shumë më të ulët- rreth një e treta e fondeve të implementuara, arsyet kryesore janë modaliteti i metodologjisë së kontratave me vetqeveritë lokale (VQL) dhe partnerët tjerë implementues.

Aq më tepër, ekzistojnë sfida sistematike lidhur me zhvillimin e infrastrukturës së re, duke filluar me çështjet brenda kadastrit, drejtoratet për planifikimin komunal, statusi i dokumentacionit planifikues dhe çështjet e pronësisë së tokës. Për këto arsye, nuk mund të pritët që vetqeverisjet lokale të posedojnë projekte të përgatitura mirë të cilat sistematikisht ngriten në parimet më të larta të qeverisjes së mirë.

Megjithkëtë, PROGRES tani është duke lëvizur nga investimet në iniciativat lokale drejt projekteve ndër-komunale që do të stimulojnë investime më të mëdha në jug dhe jugperëndim të Serbisë. Projektet Zona e Gjelbër e Leskocit dhe Zhvillimi i Agro Biznesit në Peshter pritët të hapin perspektiva punësimi dhe të radhitin një numër të aktorëve në implementim nga niveli lokal, kombëtar dhe ndërkombëtar.

Përkrahja e ofruar nga ekspertët e Qeverisë Zvicrane ka rezultuar në përmirësimin e mirëkuptimit dhe çiltërsisë së stafit të PROGRES-it ndaj këtij koncepti dhe zbatueshmërinë e Programit, por edhe ka ngritur njohurinë e subjektit tek klientët. Ekziston kuptim i zgjeruar i lidhjeve në mes të infrastrukturës dhe projekteve tjera dhe qeverisjes së mirë, si dhe synimi dhe qëllimi përfundimtar i ekzistimit të tyre. Në të njëjtën kohë, është e qartë se adresimi tek qeverisja e mirë në gjithë Programin kërkon burime dukshëm më të mëdha në pikëpamje të stafit, kohës dhe financave se sa që janë parashikuar fillimisht.

Zhvillimet në nivelin politik kanë rikonfirmuar supozimet dhe rreziqet nga Dokumenti i Programit se paqëndrueshmëria e vetqeverisjeve lokale mbetet një nga pengesat kryesore të jashtme për zbatimin e Programit. Kjo, bashkë me zgjedhjet në pritje me siguri do të paraqesë sfida të mëtejshme në zbatimin e Programit.

Ky raport është strukturuar ashtu që të ofrojë informatat kryesore lidhur me Programin dhe implementimin e tij. Pjesa i- 1 ofron informata duke përfshirë pasqyrën e situatës socio-ekonomike dhe rregulla të ndryshme që i përkasin PROGRES-it. Pjesa - 2 është një përmbledhje e aktiviteteteve të implementuara, si dhe rezultatet e arritura. Pjesa - 3 jep një pasqyrë që i përkasin rreziqeve dhe supozimeve të ekzaminuara në vitin e kaluar, përdorura Pjesa 4 jep një pasqyrë për pjesën administrative/operative të PROGRES-it. Pjesa 5 përshkruan faktorët të cilët do të sigurojnë qëndrueshmëri të Programit. Monitorimi dhe evaluimi janë sqaruar në Pjesën 6, përdorura përvojat e mësuara i takojnë pjesës së 7. Një numër aneksesh i ofrojnë lexuesit mundësi të fitojnë njohuri më të thella të disa veprimeve specifike të ndërmarra nga Programi.